



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

i mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14.9.2023, duke filluar në orën 8:30.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri dhe Shegë Beqiri.

Mungoi: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, Valbona Ahmeti – Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Pëllumb Bajçinovci - kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

1. Propozim-vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2024.

Kryesuesi: - tha, lidhur me Propozim-vendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2024, fjalën ia japim Valbona Makollit - drejtore e financave.

Për këtë pikë të pranishmit në pika të shkurta i informoi drejtoresha Valbona Makolli, ku tha se para se të fillojmë me buxhet po iu njoftoj, që sipas Qarkores 02/2024 kemi mbajtur 5 dëgjime buxhetore para kësaj. Dëgjimet buxhetore janë mbajtur me kërkesën e anëtarëve të Kuvendit në muajin korrik, në ditën e fundit të dëgjimeve buxhetore, prej 51 asamblistëve vetëm 2 kanë qenë prezent dhe i falënderoj publikisht, si dhe i kam marrë kërkesat e tyre, të cilat janë të publikuara dhe i kam dorëzuar në drejtorinë përkatëse, i kam njoftuar që këto janë kërkesat, tash kërkesat a janë përfshirë në kuadër të një projekti apo janë në vazhdimësi të punimeve, atëherë drejtorët në mbledhje iu njoftojnë. Për shembull, një prej kërkesave shumë të mëdha dhe shumë esenciale është edhe mungesa e transportit publik, që i ka paraqitur asambleja për pjesën që e përfaqëson, në ç'rast ka kërkesa për shtrim të rrugëve, ndriçim etj por ka qenë shumë i theksuar transporti publik. Ne kemi bërë rritjen prej 1 milion eurove, ndërsa vitin e kaluar ishin 5 milionë për transport, tani kemi edhe 1 milion shtesë për blerjen e flotës së re dhe në disa pjesë ku ka më pak popullatë mendojmë të sigurojmë kombibus. Problem kryesor që është paraqitur dhe

na ka përcjellë gjatë tërë vitit janë mbeturinat, ku aty e kemi bërë një dyfishim prej 3 milionë që ka qenë kostoja që e kemi planifikuar tash, kurse për detajet tjera po besoj që në mbledhje do të vijnë drejtorët dhe do t'ju përgjigjen kërkesave tuaja. Te mallrat edhe shërbimet, te Drejtoria e Shërbimeve Publike shpenzimet e transportit urban dhe operatorëve privat që janë 6 milionë, 4 milion janë grant qeveritar, 2 milionë janë të të hyrave vetanake, pastaj pas asaj linje ke menaxhimin e mbeturinave 2 milionë e 462 euro grant qeveritar, 2 milionë e 388 janë të hyra vetanake dhe 4 milionë e 800 nuk do të thotë se do ndalemi këtu, meqenëse deri tani i kemi afër 80% të realizimit të të hyrave, si dhe do të ketë tejkalim të të hyrave vetanake. Sipas qarkores së fundit, Kryeqyteti për vitin 2024 do të ketë buxhet 123,699,998 euro, nga kjo vlerë kemi Ligjin për Kryeqytetin kemi 17,080.800 euro, Granti specifik për arsim është 26,505,354 dhe Granti për shëndetësi 10,456,520 euro. Këto dy grante specifike janë shumë të ulëta sipas kërkesës dhe planifikimeve të këtyre dy drejtorive. Shtrohet pyetja a ka dallim mes vitit 2023-2024 dhe në cilat kategori, - ka një ndryshim prej 13 milionë ku pjesa më e madhe është te pagat dhe mëditjet ku kemi një diferencë prej 7 milionë e gjysmë euro, në mallra dhe shërbime kemi një diferencë prej 3 milionë, në Komunali kemi një diferencë 252.000 eurove, në subvencione dhe transfere kemi një diferencë prej 350.000 euro dhe në Investime kapitale kemi në diferencë prej 3,094,344 euro. Do të ketë edhe tejkalim të të hyrave sipas trendeve që jemi duke shkuar vetëm në muajin e tetë i kemi diku rreth 80% të realizuara pa e llogaritur shtatorin dhe i kemi të hyrat indirekte d.m.th. të hyrat prej gjobave dhe prej gjykatave që TM 3 mbledhet pas janarit sepse viti mbyllet më 31 dhjetor.

Leutrim Retkoceri: - tha se mendon se ka një nguti të shtyrjes së projekteve, kur po them nguti është një procedurë që ka mundur m'u përfill, çështja e organizimit të dëgjimeve publike të ekzekutivit dhe të komunës në raport me qytetarin është, por është një kohë që duhet ta ketë Kuvendi për ta trajtuar këtë dokument dhe me trajtuar në formën e vet edhe para qytetarit, kurse kjo nuk është respektuar hiq. Ai tha se kjo është një mungesë për buxhetin që po flasim sot. Po ashtu tha se sot pret në Kuvend gjithë drejtorët për t'i arsyetuar gjitha pikat e projekteve që i kanë fut, se problemi kyç po vazhdon me mbet në buxhet sepse kur po vjen fundi i vitit po kemi mjaft suficit buxhetor, kurse për këtë përgjegjës janë drejtorët se ata i dinë gjitha fazat e projektit, andaj unë mendoj për këto çështje jemi duke pas vonesë. Pastaj ai ceku çështjen e transportit publik që u përmend që ka kërkesa jashtëzakonisht prej qytetarëve me pas qasje në të gjitha lagjet me transport publik, komuna është duke e nënshkruar një kontratë me Bankën Botërore për sjelljen e autobusëve të rinj, një kredi e ka nënshkruar, mirëpo qysh ka me zgjeruar transportin publik me operatorë privat kur janë shtuar në buxhet vetëm 1 milion euro, nga do t'i sigurojë pjesën tjetër të parave d.m.th na nuk kemi rritje të buxhetit në këtë kategori dhe kjo është sfiduese. Tutje ai ceku se çështje tjetër është te investimet kapitale që ka të bëjë më shumë me projektet të mëdha brenda qytetit, a ka ndonjë plan strategjik si është menduar me shkuar deri te kjo dhe çështje tjetër është total e pambuluar pjesa rurale e qytetit, fshatrat që janë një sfidë në vete se ideja e koncentrimit të zhvillimit të qytetit është vetëm brenda zonës së qendrës ose pak përreth.

Valbona Makolli: - dha sqarime lidhur me çështjet që i ceku Leutrimi.

Milazim Vitija: - tha po flasim për pikën më të ndjeshme të këtij viti, për buxhetin e vitit 2024, e ceku edhe Leutrimi që buxheti është orientuar brenda qytetit dhe me projekte të mëdha edhe unë pajtohem me Leutrimin se nuk duhet anashkaluar edhe pjesën rurale dhe fshatrat e Prishtinës. Unë kam qenë në diskutim publik, i kam bërë kërkesat e mija, janë shkurtuar, janë larguar krejt, mirëpo unë e di që kërkesat e banorëve janë jetike dhe nuk janë duke kërkuar asgjë të jashtëzakonshme, por ka lagje dhe fshatra që

banorët nuk mund të shkojnë në shtëpi të vet me vetura, kështu që duhet të keni kujdes sepse nuk mbahen fshatrat pa transport publik, pa kujdes shëndetësor dhe kanë filluar shkollat të mbyllen, andaj duhet këto çështje të diskutohen në Kuvend.

Valbona Makolli: - tha se është në dijeni për gjendjen e pjesëve rurale dhe është e shqetësuar për këtë gjendje të fshatrave.

Milazim Vitija: - tha, pasi që ka suficit të buxhetit për kryeqytetin, kërkesat janë jetike, nuk po kërkojnë diçka modernizim, po kërkojnë të rregullohet rruga për udhëtim sa më të lehtë.

Valbona Makolli: - tha se do të bisedojë me drejtorin për këtë çështje dhe do të ketë parasysh.

Leutrim Retkoceri: - tha se i ka ardhur një kërkesë para 3-4 muajve nga banorët e zonës së fshatit përmbi Badovc e tutje që jetojnë afër ujit, por nuk kanë ujë të pijshëm se fekalet e tyre derdhen aty dhe në buxhet nuk pash që ka diçka, kurse kjo çështje është jetike për të gjithë edhe për ata banorë që jetojnë atje.

Valbona Makolli: - tha jo nuk është në buxhet, ata banorë kanë qenë këtu, është një marrëveshje me KFB-Gjermane mes Komunës dhe KRU "Prishtinës", nuk është nënshkruar ende se ata nuk i kanë definuar, por ne duhet të financojmë me 9 milionë euro sepse jemi zotuar, ndërkaq Fushë Kosova dhe Ujësajllësi "Prishtina" do të financojnë me 11 milionë euro.

Leutrim Retkoceri: - tha, nëse ata qytetarë organizohen dhe paditin Komunën e Prishtinës, e fitojnë sepse e drejtë elementare është komuna t'i furnizojë banorët e vet me ujë, rrymë dhe kanalizim pasi janë çështje bazike. Po ashtu tha se e shoh të arsyeshme se duhet këto sot me u shqyrtuar dhe të merret përgjigje për të gjitha sepse në këtë formë ne e përmbushim detyrën e të zgjedhurve të kryeqytetit.

Valbona Makolli: - tha pajtohem plotësisht me ty Leutrim, mendimi im profesional në këtë pjesë është se pa bashkëpunim me Ujësajllësin dhe KESCO-n e kemi pak të vështirë për zhvillim të infrastrukturës. Sa i përket një strategjie, me drejtorin e bujqësisë kemi punuar mirë vitin e kaluar, kemi provuar me iu dhënë serra, por shumë pak njerëz kanë qenë të interesuar për serra, ne kemi bërë edhe strategji me hapur puse, d.m.th nuk ka interesim të njerëzve që dëshirojnë me punuar dhe aplikimi ka qenë shumë i vogël.

Leutrim Retkoceri: - tha mos t'i shikojmë vetëm gjërat që na po i diskutojmë çka nuk janë, por ka edhe vërejtje të mira p.sh çështja në bujqësi neve na ka treguar drejtori Platori që ka në plan hartimin e strategjisë për agroturizëm që është shumë me rëndësi.

Valbona Makolli: - tha edhe drejtoresha e kulturës e ka strategjinë se nuk mundemi pa strategji të kulturës. Po ashtu tha po mundohemi ta bëjmë të pamundurën me këto mundësi buxhetore, por te investimet kapitale tash janë drejtorët, kurse ne jemi në mes dy luftërave. Ata po bëjnë të pamundurën, jo projektet në OPSH në anën tjetër kur të shikosh ne kemi suficit marramendës.

Jeta Rafuna: - pyeti sa do të jetë këtë vit suficiti.

Valbona Makolli: - tha, në momentin që e kam përgatit raportin kanë qenë edhe 75 milionë suficit.

Mbledhja përfundoi në orën 9:40.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

Faqe3nga3

**Kryesues i Komitetit
Pëllumb Bajçinovi**

